

TREGIM SUKSESI

Fuqizimi i grave për mundësi të barabarta



Syri i Vizionit gjatë një tryeze të rrumbullakët duke avokuar për fuqizimin e grave.

Gratë në Kosovë përbëjnë gjysmën e popullatës, mirëpo pjesëmarrja e tyre në jetën politike dhe ekonomike mbetet mjaft e kufizuar. Sipas statistikave 60% e grave në Kosovë janë deklaruar si joaktive për punë, ndërsa një fakt tjetër shqetësues është se gratë e moshave 24-34 vjeçare janë deklaruar si amvise. Me mbështetjen e Programit Angazhimi për Barazi – E4E, Syri i Vizionit – një organizatë joqeveritare vendore, po punon në promovimin dhe ndërtimin e kapacitetit të grave për të ndryshuar situatën dhe të përmirësojnë përfaqësimin e grave në sektorin publik.

Zbatimi i projektit “Mbështetja për gratë” lehtëson fuqizimin e pozitës së grave në pozita udhëheqëse por edhe vendim-marrëse, ndërsa intervenimet në rregulloret komunale të Pejës, Deçanit, Istogut dhe Junikut tashmë janë iniciuar. Kjo është bërë me qëllim që t’ju ofrohen grave mundësi të barabarta në qasje tek dokumentet zyrtar, ku gjuha e ndjeshme në aspektin gjuhësor mungon.

Këshilltaret komunale, zyrtaret për barazi gjinore dhe për informim janë ftuar fillimisht për të analizuar

rregulloret. Rregulloret janë përzgjedhur bazuar në zbrazëtirat për intervenim. Më vonë, punëtoritë janë organizuar me ekspert dhe janë analizuar amendamentet dhe ndryshimet. Takime janë zhvilluar edhe me Kryetarët e Kuvendeve dhe me këshilltaret komunale, dhe janë diskutuar të gjitha opsionet për ndryshime të dokumenteve zyrtare.

Gjatë këtij procesi, të gjitha katër Komunat themeluan Komisionin që të punojë në përfshirjen e ndryshimeve dhe integrimin sa më të shpejtë në agjendën e Kuvendit. Komuna e Pejës, tashmë ka arritur ta përfshijë amendamentin në rregullore. Ky amendament është miratuar në Kuvendin Komunal në Janar të 2017-ës, si një nismë e grupit të grave të Pejës të kyçura në projekt. Neni 15, pika 1.6 lidhur me kushtet, kriteret dhe procedurat për ndarjen e subvencioneve është futur dhe përfshirë si kriter, kështu që në rast kur përfituesja është “femër e vetme në krye të familjes (shtëpisë)” do t’i ofrohet ndihmë në përfitimin e subvencioneve dhe bursave nga Komuna e Pejës.

Tetë rregullore Komunale janë në proces të amendamentimit në komunat e tjera të synuara. Këto amendamente do të garantojnë barazinë e grave në Komitete, Grupe Punuese, etj. lidhur me subvencionet, bursat, dhe krijimin e kushteve më të mira për pjesëmarrje të grave në nivel lokal.

Syri i Vizionit është duke zbatuar projektin “Projekti për Mbështetjen e Grave” përkrahur nga Programi Angazhimi për Barazi - E4E që financohet nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar – USAID, dhe implementohet nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokokim – ATRC.